

**KONTRATË
PËR SHIT- BLERJE KUOTASH**

Në Tiranë, sot në datën 04.10.2019 (dy mijë e nëntëmbëdhjetë), midis nesh paleve:

**PALËT KONTRAKTUESE
PALA SHITËSE**

Znj. Juliana Sinanaj, e bija e Hetemit, e datëlindjes 07.01.1983, lindur në Skrapar e banuese në Tiranë, Komuna Parisit, prane Lulishtes, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar. Mbajtëse e Letërnjoftimit ID I35107049V, ortake e vetme, zotërues i 100% të kuotave e shoqërisë "PARALLEL" sh.p.k., regjistruar në QKB më datë 08.11.2018, me NIPT L82308003E, me seli në adresën: Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga Abdyl Frashëri, Pallati 1/1, Shkalla 1, Ap.3, Tiranë, me status AKTIV, zotëruese e një kuotë me vlerë 100.000 (njëqind mijë) Lekë, me pjesëmarrje në përqindje (100%). Që këtu e më poshtë në këtë kontratë do të quhet - "SHITËSJA"

PALA BLERESE:

Z.Ledion ZOI, i biri i Lllazarit, i datëlindjes 26.08.1987, lindur në Fier, dhe banues në Tiranë në adresën: Komuna Parisit, prane Lulishtes, i identifikuar me letërnjoftimin elektronik me Nr 030947775 dhe Nr. Personal I70826089V, lëshuar më datë 15.04.2011, madhore me zotësi të plotë për të vepruar; Që këtu e më poshtë do të quhet - "BLERËSI"

Bazuar në të dhënat e shoqërisë "PARALLEL" sh.p.k sipas Ekstraktit të lëshuar nga QKB, rezulton se shoqëria "PARALLEL" sh.p.k është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar. Selia e kësaj shoqërie është në Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga Abdyl Frashëri, Pallati 1/1, Shkalla 1, Ap.3, Tiranë. Kjo shoqëri është themeluar me datë 01.11.2018 dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me datë 08.11.2018 e cila identifikohet me NIPT L82308003E. Kapitali themeltar i kësaj shoqërie është 100.000,00 (njëqind mijë) Lekë. Shoqëria "PARALLEL" sh.p.k zotërohet nga ortakja e vetme Juliana Sinanaj e cila zotëron 100% të kapitalit, 1 kuotë me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) Lekë. Kjo shoqëri ka për objekt të veprimtarisë së saj aktivitetin në *Shërbime të ndryshme dhe shërbime konsulencë mbi: Kërkim tregu; Plane Biznesi; Shkrim, Zhvillim, Menaxhim Projektesh; Ndërtim Kapacitetesh, Plan Marketingu; Strategji Komunikimi; Fushata Komunikimi Marketing; Krijim Identitet Marke; Përgjegjësi Sociale e Koorporatave; Evente; Planifikim Urban, Zhvillim Territori, Shërbime në fushën e planifikimit të peisazhit.*

BAZA LIGJORE

Kjo kontratë hartohet në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 9901 i datës 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar dhe Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil", i ndryshuar.

OBJEKTI

Objekti i kësaj kontrate është, shitja e 1 (Një) kuote me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) Lekë, që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë të zotëruar nga ortakja e vetme Znj.Juljana Sinanaj dhe blerja e kësaj kuote nga Z.Ledion Zoi.

Shitësja nëpërmjet kësaj kontrate deklaron se me vullnet të lirë dhe të plotë si dhe në bazë të legjislacionit në fuqi dëshiron që ti transferojë nëpërmjet shitjes kuotën si në paragrafin më sipër që ai disponon në kapitalin e kësaj shoqërie në favor të Z.Ledion Zoi, i cili deklaron se është plotësisht dakort që të blejë këtë kuotë që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë të zotëruar ortakja e vetme Znj.Juljana Sinanaj.

ÇMIMI

Palët në marrëveshje të përbashkët kanë rënë dakort se çmimi i shitblerjes së kuotes që po transferohet nëpërmjet kësaj kontrate është si vijon:

100 % e kapitalit që zotërohet nga ortakja e vetme Znj.Juljana Sinanaj i shitet Z.Ledion Zoi në vlerën 100.000,00 (njëqind mijë)Lekë.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Znj.Juljana Sinanaj nuk ka asnjë pretendim financiar ndaj blerësit, Z.Ledion Zoi, e cila është likujduar nga pala, para nënshkrimit të kësaj kontrate, dhe palët deklarojnë se nuk kanë dhe nuk do të kenë asnjë pretendim për këtë në të ardhmen. Dhe konkretisht Znj.Juljana Sinanaj deklaron në përgjegjësinë e saj personale dhe ligjore se është likujduar para nënshkrimit të kësaj kontrate, e nuk ka asnjë pretendim financiar kundrejt blerësit Z.Ledion Zoi, sot, apo në të ardhmen.

DEKLARIME DHE GARANCI

Pala shitëse deklaron dhe garanton palën blerëse se është zotëruesi i ligjshëmi kapitalit që po transferon nëpërmjet shitjes sipas kësaj kontrate. Në rast të kundërt pala shitëse merr përsipër personalisht zgjidhjen e cdo lloj konflikti.

Në të njëjtën kohë, pala shitëse merr përsipër, garanton dhe siguron palën blerëse se sot në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate kuota objekt - shitblerje:

- Është e lire nga cdo barrë, marrëveshje apo vendim tjetër kufizues;
- Nuk është objekt i ndonjë konflikti gjyqësor;
- Është e lirë nga çdo e drejtë apo pretendim i personave të tretë;
- Nuk është objekt i pretendimeve nga asnjë zyrë përmbarimi, shtetërore dhe/ose private.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi apo zbatimi i kushteve të kësaj kontrate, do të zgjidhet me bisedim dhe mirëkuptim të ndërsjellë midis palëve dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Nëse midis palëve nuk arrihet zgjidhja e çështjeve me bisedim dhe mirëkuptim, atëherë zgjidhja e mosmarrëveshjeve do të bëhet nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITËSE
JULJANA SINANAJ

Juljana Sinanaj



BLERËSI
LEDION ZOI

Ledion Zoi